

UDHËZIM
Nr.2, datë 27.1.2006

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në kapitullin VI “Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit (hartuesit e dokumenteve të tenderit)” të udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pas paragrafit të parë të shtohet teksti, me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e njësisë së prokurimit dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave përzgjidhen ndërmjet personave, të cilët nuk kanë lidhje:

- i) familjare: bashkëshort/bashkëjetues, bir/bijë dhe fëmijët e tyre;
- ii) gjinie: prindër, motër a vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj;
- iii) krushqie: prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve, me personat që ushtrojnë detyra a funksione shtetërore:

- a) President i Republikës dhe stafi i tij politik;
- b) Kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat;

c) anëtar i stafit politik të Kryeministrit;

ç) deputet;

d) titullar i institucioneve të: Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme;

dh) titullar i institucioneve qendrore, të pavarura;

e) titullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit;

ë) drejtues i Policisë së Shtetit dhe zëvendësi i tij;

f) kryetar bashkie, kryetar i këshillave bashkiake a i këshillit të qarkut, për ente prokuruese me vendndodhje brenda njësisë së bashkisë ose qarkut;

g) prefekt, kryetar i gjykatës së rrethit gjyqësor të shkallës së parë, prokuror i rrethit gjyqësor, drejtor i policisë së qarkut, për entet prokuruese me vendndodhje brenda njësisë së bashkisë ose qarkut;

gj) prokuror pranë prokurorisë së gjykatave të shkallës së parë, për ente prokuruese, për të cilat, për shkak të vendndodhjes, prokurori ka kompetencë territoriale të fillojë, ushtrojë apo mbarojë hetimin.

“Bashkëjetues” është personi, i cili cilësohet i tillë sipas nenit 163 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”.

Personat e caktuar ushtrojnë përgjegjësitë si anëtarë të njësisë së prokurimit a të komisionit të vlerësimit të ofertave, vetëm kur kanë plotësuar dhe depozituar më parë, pranë titullarit të entit, formularin e lidhjeve nepotike me pushtetin, sipas tekstit bashkëlidhur. Plotësimi i formularit kryhet për çdo tender. Formulari administrohet dhe vendoset në ruajtje, së bashku me dokumentacionin e prokurimit. Punonjësi i entit ose personi i jashtëm mban përgjegjësi personale dhe lirohet menjëherë nga detyra që kryhen, nëse nga një kontroll i ushtruar ose nga informacionet e mbërritura në ent rezulton se ai ka kryer deklarime të pavërteta, pavarësisht ligjshmërisë apo rregullsisë së veprimeve të tij në tender.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, ky dokument

është i hapur për publikun.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI PROKURUES**

Formular deklarami:

Deklaruesi: _____

Pozicioni: _____

Vendi i punës: (Drejtoria/sektori) _____

Në mbështetje të udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,
unë nënshkruesi _____,

(emër, atësia, mbiemër)

kandidat për anëtar në njësinë e prokurimit/komisionin e vlerësimit të ofertave, sipas urdhrit
nr.____, datë _____, të titullarit të institucionit bashkëlidhur, sot më datë ____/____/2000
(data, muaji, viti)

nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se

_____lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë, brenda rrethit të personave me pushtet të
caktuar në kapitullin IV të këtij udhëzimi:

Kjo deklaratë është hartuar me të
dhënat në ditën e deklaramit

_____/_____/200____

Nënshkruesi _____

DEKLARATA PLOTËSOHET NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.